

Kërkesë për Ofertë

Përforcimi i ISMS dhe Sigurimi i Infrastrukturës
Teknologjike Mbështetëse në Kuadër të Kërkesave
Rregullatore

Nr. Ref: 20260226

Data e hapjes së procesit të prokurimit: 26/02/2026

Afati i fundit për pyetjet: 10/03/2026

Afati i fundit për dorëzimin e ofertave: ora 15:00, data 17/03/2026

Lënda:

Përcillet për njohje procedura për “Prokurim i produkteve dhe shërbimeve përkatëse për projektin “Përforcimi i ISMS dhe Sigurimi i Infrastrukturës Teknologjike Mbështetëse në Kuadër të Kërkesave”

1. Objekti i Procedurës së Prokurimit

Kjo procedurë përfshin kater tenderë të ndërlidhur funksionalisht:

- Tender Nr. 1 – Asistencë profesionale për rishikimin, zhvillimin dhe standardizimin e dokumentacionit ISMS sipas ISO 27001.
- Tender Nr. 2 – Prokurimi i një zgjidhjeje teknike për ruajtjen dhe rikuperimin e të dhënave.
- Tender Nr. 3 – Prokurimi i pajisjeve kompjuterike për mjedisin e punës (15 PC).
- Tender Nr. 4 – Prokurimi i pajisjeve Rack (kabinete serveresh) (2 njesi)

Ofertuesit mund të aplikojnë për një, disa ose të katër tenderët.

2. Konteksti i Prokurimit

Kjo procedurë zhvillohet në mbështetje të objektivave të përcaktuara në Tenderin Nr. 1, i cili synon vendosjen e një Sistemi të Menaxhimit të Sigurisë së Informacionit (ISMS). Edhe pse vlerësimi përfundimtar i tenderit të parë nuk është finalizuar, analiza paraprake ka treguar se disa produkte, pajisje dhe zgjidhje teknike janë të domosdoshme për të garantuar zbatimin efektiv të kërkesave të ISMS dhe përputhshmërinë me ligjet dhe standardet e sigurisë së informacionit. Për këtë arsye, tenderët Nr. 2 & Nr. 3 prokurohen paralelisht, me qëllim sigurimin e infrastrukturës teknike mbështetëse që në këtë fazë.

3. Dokumentet Përbërëse të Procedurës (Anekset)

- Aneks A - Tender 1 - Asistence ne përgatitjen e dokumentacionit sipas 27001
- Aneks B - Tender 2, 3 & 4 - Prokurim i produkteve Pajisje dhe Solutions

Ky dokument nuk përfshin specifikimet teknike; ofertuesit duhet t’u referohen ekskluzivisht Anekseve.

4. Kriteret e Përbashkëta Administrative

- Formulari i ofertës (i firmosur dhe i vulosur).
- Ekstrakt historik/NIPT i subjektit.

- Dokument identifikimi dhe autorizimi i përfaqësuesit ligjor.
- Vërtetim i gjendjes tatimore dhe sigurimeve.
- Deklaratë për konflikt interesi.
- Deklaratë për pranimin e kushteve të procedurës.
- Dokumentacioni teknik sipas tenderit përkatës.
- Garanci e ofertës (nëse aplikohet).

5. Vlera dhe Përgatitja e Ofertës Financiare

- Oferta financiare duhet të jetë në LEK (ALL).
- Çmimet duhet të jenë me TVSH të përfshirë.
- Ofertuesi duhet të paraqesë çmim njësi, çmim total dhe TCO (3–5 vjet) kur kërkohet.
- Ofertuesi duhet e përfshijë termat e likuidimit të faturës së ofertës financiare.

6. Vlefshmëria e Ofertës

Oferta duhet të jetë e vlefshme për minimum 60 ditë nga data e dorëzimit.

7. Afatet e Ekzekutimit (përcaktohen nga ofertuesi)

Ofertuesi propozon vetë afatin e ekzekutimit; afatet do të vlerësohen si pjesë e kriterëve të përzgjedhjes.

8. Mënyra e Dorëzimit të Ofertës

Ofertat dorëzohen fizikisht të firmosura dhe vulosura në adresën SiCRED, Rr. Brigada e VIII, Nr. 3/1, Tiranë.

Afati i fundit për dorëzimin: 17/03/2026

9. Kriteret e Përbashkëta të Vlerësimit

- Përputhja me specifikimet teknike (Aneks A & B).
- Afatet e propozuara të ekzekutimit.
- Termat financiare.
- Dokumentacioni ligjor dhe teknik.
- Cilësia e zgjidhjes dhe qasja teknike.

10. Klauzola të Përgjithshme

- SiCRED mund të kërkojë qartësime ose të anulojë procedurën.
- Mospërputhja me kërkesat e këtij dokumenti ose të Aneksëve sjell skualifikim.
- Gjuha e procedurës: Shqip.

11. Kontakti për Pyetje dhe Qartësime

Pyetjet dërgohen deri më 10/03/2026 në adresën Email: contact@sicred.com.al

Genc KOXHAJ

Drejtor i Përgjithshëm